

**L I G J**  
**Nr.8077, datë 22.2.1996**

**PËR KAMBIALIN DHE PREMTIM-PAGESËN**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

TITULLI I  
KAMBIALI

KREU I  
EMETIMI DHE FORMA E KAMBIALIT

Neni 1

Kambiali përmban:

1. Termin “kambial” të shkruar në trupin e instrumentit dhe të shprehur në gjuhën e përdorur për hartimin e këtij instrumenti.
2. Një urdhër të pakushtëzuar për të paguar një shumë të caktuar parash.
3. Emrin e personit që është i detyruar të paguajë kambialin (pritësi).
4. Një deklaratë të kohës së pagesës.
5. Një deklaratë të vendit ku kryhet pagesa.
6. Emrin e personit të cilit ose të cilëve u kryhet urdhër-pagesa.
7. Një deklaratë të datës dhe vendit ku emetohet kambiali.
8. Nënshkrimin e personit që emeton kambialin (lëshuesi).

Neni 2

Në qoftë se në një kambial nuk përmbushet ndonjë nga kërkesat e mësipërme, atëherë ky kambial nuk është i vlefshëm si i tillë, përveç rasteve të dhëna në paragrafët e mëposhtëm.

Një kambial në të cilin nuk është përcaktuar koha e pagesës quhet si i pagueshëm “me të parë”. Në mosplotësimin e kërkesave të nenit 1, vendi i pagesës do të konsiderohet vendi i përcaktuar pranë emrit të pritësit, që në të njëjtën kohë është edhe vendi i vendbanimit të përhershëm të tij.

Një kambial në të cilin nuk është përmendur vendi i emetimit të tij quhet si i hartuar në vendin e dhënë pranë emrit të lëshuesit.

Neni 3

Një kambial mund të jetë i pagueshëm me urdhër të lëshuesit.  
Kambiali mund të lëshohet mbi vetë lëshuesin.  
Kambiali mund të lëshohet për llogari të një personi të tretë.

Neni 4

Një kambial mund të paguhet në vendbanimin e përhershëm të një personi të tretë, në vendin ku pritësi ka vendbanimin e tij të përhershëm ose në një vend tjetër.

#### Neni 5

Kur një kambial është i pagueshëm “me të parë”, ose në një kohë të përcaktuar, lëshuesi mund të kushtëzojë në të që shuma e pagueshme të mbartë interesa të përcaktuara.

Në raste të tjera kushtëzimi i mësipërm quhet i pashkruar.

Përqindja e interesit përcaktohet në kambial sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil. Në të kundërtën kushtëzimi quhet i pashkruar.

Interesi hyn në fuqi nga data e maturimit të kambialit, nëse nuk përcaktohen data të tjera maturimi.

#### Neni 6

Nëse në shumën e pagueshme të kambialit të shprehur me fjalë e me shifra jepet mospërputhje e fjalëve dhe shifrave, atëherë shuma e pagueshme është shuma e shprehur me fjalë.

Nëse ka mospërputhje në shumën e pagueshme të kambialit të shprehur më shumë se një herë me fjalë ose me shifra, atëherë shuma e pagueshme do të jetë shuma më e vogël e shprehur.

#### Neni 7

Nëse kambiali përmban nënshkrime të personave të pazotë për të nënshkruar një kambial, nënshkrime të falsifikuara e nënshkrime të personave fiktivë, ose nënshkrime që për çdo arsye tjetër nuk i detyrojnë personat që kanë nënshkruar ose në interes të të cilëve kambiali ishte nënshkruar, atëherë do të jenë të vlefshme detyrimet e personave të tjerë që kanë nënshkruar kambialin.

#### Neni 8

Cilido person që vendos nënshkrimin e tij mbi kambial, si përfaqësues i personit që nuk ka fuqi të veprorë (sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil), do të detyrohet si palë në kambial dhe, në qoftë se ka paguar, ka të gjitha të drejtat që do të kishte personi për të cilin pretendon ai se ka vepruar.

I njëjti rregull zbatohet për çdo përfaqësues që tejkalon fuqitë e tij.

#### Neni 9

Lëshuesi garanton pranimin dhe pagesën e kambialit.

Lëshuesi mund ta lirojë veten e tij nga pranimi i garantimit. Çdo kushtëzim nga ku ai liron veten nga garantimi i pagesës quhet si i pashkruar.

#### Neni 10

Nëse kambiali kur emetohet nuk është i plotë, ose plotësohet ndryshe nga sa është rënë dakord në marrëveshje, atëherë kambiali nuk do t'i jepet mbajtësit, me përjashtim të rasteve kur ky i fundit e përfiton kambialin në keqbesim ose neglizhencë të theksuar.

## KREU II XHIRIMI

### Neni 11

Në rast se në kambial nuk është shkruar shprehimisht shprehja “me urdhër”, atëherë ky kambial do të transferohet me xhirim.

Nëse hartuesi i kambialit shkruan në kambial shprehjen “jo me urdhër” ose një shprehja ekuivalente me të, atëherë kambiali transferohet vetëm në përputhje me formën dhe me efektet e një emetimi të tillë.

Kambiali xhirohet në favor të pritësit (nëse ai pranon atë) ose në favor të lëshuesit a në favor të çdo pale tjetër në kambial. Këta persona mund ta rixhirojnë kambialin.

### Neni 12

Xhirimi është i pakushtëzuar. Çdo kusht i vendosur në kambial quhet se nuk është shkruar.

Xhirimi pjesor është i pavlefshëm.

Xhirimi “te mbajtësi” është ekuivalent me një xhirim në të bardhë.

### Neni 13

Xhirimi shkruhet mbi kambial ose në një shirit letre bashkëngjitur atij. Ai nënshkruhet nga xhiruesi.

Xhirimi në të bardhë është xhirimi që e le përfituesin të paspecifikuar, ose qëndron vetëm në nënshkrimin e xhiruesit. Në këtë rast xhirimi, për të qenë i vlefshëm, shkruhet prapa kambialit ose mbi shiritin bashkëngjitur atij.

### Neni 14

Xhirimi transferon çdo të drejtë që rrjedh nga kambiali.

Nëse xhirimi është në të bardhë, atëherë mbajtësi:

1. Plotëson vendin bosh (të bardhë) me emrin e tij ose me emra të personave të tjerë.
2. E xhiron kambialin përsëri në të bardhë ose në favor të personave të caktuar.
3. Transferon kambialin në favor të një personi të tretë, pa e plotësuar vendin bosh dhe pa e xhiruar atë.

### Neni 15

Xhiruesi, në mungesë të çdo dispozite të kundërt, garanton pranimin dhe pagimin e kambialit.

Xhiruesi mund të ndalojë një xhirim të ri të kambialit. Në këtë rast ai nuk është përgjegjës kundrejt personit, në favor të të cilit kambiali xhirohet.

### Neni 16

Mbajtësi i kambialit konsiderohet si mbajtës i ligjshëm i tij, në qoftë se e përligj të drejtën e tij me një seri të vazhdueshme xhirimesh, megjithëse xhirimi i fundit i kambialit ishte në të bardhë.

Në këtë rast xhirimet e anuluar do të quhen si jo të shkruara. Nëse xhirimi në të bardhë ndiqet nga një xhirim tjetër, personi që nënshkroi xhirimin e fundit është ai që fitoi kambialin me

anë të xhirit në të bardhë.

Nëse një personi i hiqet e drejta e pronësisë ndaj kambiali, atëherë mbajtësi i ri i kambialit, i cili justifikon të drejtën e tij të pronësisë ndaj këtij kambiali sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, nuk është i detyruar të japë kambialin, përveç rasteve kur ai e ka fituar atë në keqbesim ose kur në fitimin e tij ka pasur pakujdesi të rëndë.

#### Neni 17

Personat, kundrejt të cilëve është ngritur padi për një kambial, nuk mund të mbrohen kundrejt mbajtësit duke u bazuar në marrëdhëniet e tyre personale me lëshuesin ose me mbajtësin e mëparshëm, përveç rasteve kur mbajtësi gjatë përfitimit të kambialit ka vepruar në mënyrë të ndërgjegjshme në dëm të debitorit.

#### Neni 18

Kur një xhirim përmban shprehjet “vlerë për arkëtim”, “për arkëtim”, “me prokurë” ose çdo lloj fraze tjetër që nënkupton një mandat të thjeshtë, mbajtësi mund të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kambiali, por ai mund ta xhirojë atë vetëm me prokurë të posaçme.

Në këtë rast palët e detyruara mund t'i ngrenë mbajtësit të kambialit vetëm ato pretendime që mund të ngrinin kundër xhiruesit.

Mandati që përmbahet në një “xhirim me prokurë” nuk mbaron për shkak të vdekjes së palës që ka dhënë mandatin, ose për shkak të bërjes së saj ligjërisht të paaftë.

#### Neni 19

Kur një xhirim përmban shprehjen “vlera në sigurim”, “vlera të lëna peng”, ose për çdo shprehje tjetër që nënkupton diçka të lënë peng, mbajtësi mund të ushtrojë të gjitha të drejtat e tij që rrjedhin nga kambiali, por një xhirim nga ana e tij ka vetëm efektin e xhirit me prokurë të posaçme.

Palët e detyruara nuk mund ta ngrenë ankesën e tyre kundër mbajtësit, duke u bazuar në marrëdhëniet e tyre personale me xhiruesin, përveç rasteve kur mbajtësi në përfitimin e kambialit ka vepruar me vetëdije në dëm të debitorit.

#### Neni 20

Xhirimi pas maturimit ka të njëjtat efekte si xhirimi para maturimit. Megjithatë një xhirim i bërë pas protestës për mospagim, ose pas kalimit të kufirit kohor të caktuar për të hartuar këtë protestë, vepron vetëm si një transferim i zakonshëm.

Një xhirim pa datë do të parashikohet sikur është kryer mbi kambialin përpara kalimit të kufirit kohor të caktuar për hartimin e protestës, derisa nuk është provuar e kundërta.

### KREU III PRANIMI

#### Neni 21

Mbajtësi i kambialit ose një zotërues i thjeshtë i kambialit mund ta paraqesë kambialin për pranim te pritësi (në vendbanimin e tij) deri në maturimin e tij.

#### Neni 22

Në çdo kambial, lëshuesi mund të përcaktojë që kambiali do t'i paraqitet për pranim me ose pa fiksimin e një limiti kohor për paraqitje.

Lëshuesi mund të ndalojë paraqitjen për pranim të një kambiali përveç rasteve kur kambiali është në adresë të një pale të tretë ose në një vendbanim tjetër nga ajo e pritësit, ose përveç rasteve kur kambiali do të paguhet në një periudhë kohe fikse pas parjes së tij.

Lëshuesi gjithashtu mund të kushtëzojë që paraqitja për pranim të mos kryhet në vendin e përcaktuar, përpara datës së caktuar.

Në qoftë se lëshuesi nuk ka ndaluar pranimin, çdo xhirues mund të kushtëzojë paraqitjen e kambialit për pranim, me ose pa fiksimin e një kohe të caktuar për paraqitje.

#### Neni 23

Kambiali i pagueshëm në një kohë fikse “pas parjes” duhet të paraqitet për pranim brenda 1 viti nga data e lëshimit të tij.

Lëshuesi mund të shkurtojë ose të zgjatë këtë periudhë kohe.

Kjo periudhë kohe mund të shkurtohet edhe prej xhiruesve.

#### Neni 24

Pas paraqitjes së parë të kambialit, pritësi mund të kërkojë që kambiali t'i paraqitet atij në një kohë të dytë. Palët e interesuara nuk lejohen të vendosin për një kërkesë të tillë, në qoftë se kjo kërkesë nuk është përmendur në protestë.

Mbajtësi nuk është i detyruar t'i dorëzojë pritësit kambialin e paraqitur për pranim.

#### Neni 25

Pranimi shkruhet mbi kambial. Ai shprehet nga fjala “pranuar” ose nga ndonjë fjalë tjetër e barasvlefshme. Ai nënshkruhet nga pritësi.

Nënshkrimi i njëjtë i pritësit mbi faqen e kambialit ligjëson pranimin nga ana e tij.

Kur kambiali është i pagueshëm në një kohë të caktuar pas parjes, ose kur lidhet me një kusht të veçantë dhe duhet të jetë i paraqitur për pranim brenda një kufiri të caktuar kohe, pranimi quhet i datuar që nga dita kur ai është dhënë, përveç rasteve kur mbajtësi kërkon që ai të jetë datuar që nga dita e paraqitjes.

Në qoftë se pranimi është bërë pa datë mbajtësi, për ruajtjen e së drejtës së kërkesës së tij kundrejt lëshuesit dhe xhiruesve, duhet të konstatojë mungesën e datës me anë të një proteste të nxjerrë brenda një kohe të caktuar.

#### Neni 26

Pranimi është i pakushtëzuar, por pritësi mund ta kufizojë atë në pjesën e shumës së pagueshme.

Çdo modifikim tjetër i bërë mbi një pranim në përmbajtjen e kambialit, do të refuzohet për t'u pranuar, megjithatë pranuesi detyrohet të pranojë kambialin brenda kufijve të kompetencave të tij.

#### Neni 27

Kur lëshuesi ka përcaktuar në kambial një vend pagese tjetër nga vendbanimi i përhershëm i pritësit, por nuk ka përcaktuar një palë të tretë kundrejt të cilës do të bëhet pagesa, atëherë pritësi në kohën e pranimit të kambialit mund ta emërojë këtë palë të tretë.

Në mungesë të treguesve të mësipërm, pranuesi do të quhet sikur e ka ndërmarrë ai

përsipër pagimin e këtij kambiali në vendin e pagesës.

Në qoftë se një kambial është i pagueshëm në vendbanimin e përhershëm të pritësit, ky i fundit në pranimin e kambialit mund të tregojë një adresë në të njëjtin vend ku është kryer pagesa.

#### Neni 28

Me anën e pranimit pritësi merr përsipër pagimin e kambialit duke kryer maturimin e tij. Në mospagimin e kambialit mbajtësi, edhe në qoftë se ai është lëshues, ka një veprim të drejtpërdrejtë mbi kambialin kundrejt pranuesit, për gjithçka që mund të jetë kërkuar në lidhje me nenet 48 dhe 49 të këtij ligji.

#### Neni 29

Kur pritësi ka vendosur pranimin e tij mbi një kambial, por e ka anuluar atë përpara kthimit (dhënies) të kambialit, pranimi quhet si i refuzuar.

Kur nuk mund të provohet e kundërta, anulimi quhet si i bërë përpara se të jetë kthyer kambiali.

Megjithëkëtë, në qoftë se pritësi ka njoftuar pranimin e tij me shkrim drejtuar mbajtësit ose te ndonjë palë, e cila ka nënshkruar kambialin, ai është përgjegjës te këto palë sipas kushteve të pranimit të tij.

### KREU IV GARANCIA

#### Neni 30

Pagesa e një kambiali mund të jetë e garantuar nga një “garanci” si në tërësi ose në pjesë të shumës së tij.

Kjo garanci mund të jetë dhënë prej një personi të tretë, ose edhe prej një personi që ka nënshkruar si palë në kambial.

#### Neni 31

Garancia jepet ose në kambial ose në një zgjatje të tij.

Ai është i shprehur me fjalët “për garanci”, ose nga ndonjë shprehje tjetër e njëjtë. Ai është i nënshkruar nga dhënësi i garancisë (garantuesi).

Ai quhet i ligjësuar nga nënshkrimi i plotë i garantuesit i vendosur në faqen e përparme të kambialit, përveç rasteve kur nënshkruhet nga pritësi ose nga lëshuesi.

Një “garantues” duhet të specifikojnë për llogari të kujt është dhënë garancia. Në mungesë të këtij tregimi, garancia quhet si e dhënë për lëshuesin.

#### Neni 32

Garantuesi detyrohet po në atë mënyrë që detyrohet edhe personi, për të cilin ai është bërë garantues.

Detyrimi i tij është i vlefshëm edhe sikur detyrimi, për të cilin ai garanton, është pa efekt, me përjashtim të rasteve kur ka defekte në formë.

Garantuesi që paguan një kambial, ka të drejtat që rrjedhin nga kambiali kundrejt të garantuarit dhe kundër atyre të cilët janë të detyruar ndaj tij për efekt të kambialit.

## KREU V MATURIMI

### Neni 33

Një kambial mund të përcaktohet si i pagueshëm:

- “Me të parë”.
- “Në një kohë të fiksuar pas parjes”.
- “Në një kohë të fiksuar pas datës”.
- “Në një datë të fiksuar”.

Kambiali me maturime të tjera, ose i pagueshëm me këste, është i pavlefshëm.

### Neni 34

Një kambial “me të parë” është i pagueshëm me paraqitjen e tij. Ai duhet të paraqitet për pagesë brenda një viti nga data e lëshimit të tij.

Lëshuesi mund ta shkurtojë ose ta zgjatë këtë periudhë kohe. Kjo periudhë kohore mund të shkurtohet edhe nga xhiruesit.

Lëshuesi mund të vendosë që një kambial i pagueshëm “me të parë” nuk duhet të paraqitet për pagesë përpara një date të caktuar. Në këtë rast periudha kohore për paraqitjen fillon nga data e caktuar.

### Neni 35

Maturimi i një kambiali të pagueshëm në një kohë “të fiksuar pas parjes”, përcaktohet që nga data e pranimit ose nga data e protestës.

Për pranuesin, në mungesë të protestës, një pranim pa datë do të quhet si i dhënë në ditën e fundit të limitit kohor të paraqitjes për pranim.

### Neni 36

Kur një kambial është hartuar një ose më shumë muaj “pas datës” ose “pas parjes”, kambiali do të maturohet në datën korresponduese të muajit kur duhet të ishte bërë pagesa. Në qoftë se nuk ka datë korresponduese, kambiali maturohet në ditën e fundit të këtij muaji.

Kur një kambial është hartuar një gjysmë muaji, një muaj ose më shumë se një muaj “pas datës” ose “pas parjes”, në fillim do të llogariten të tërë muajt e plotë.

Në qoftë se maturimi është fiksuar në fillim, në mes ose në fund të muajit, me këtë do të nënkuptojmë që kambiali maturohet me datën 1, 15 ose në datën e fundit të muajit.

Shprehja “tetë ditë” ose “pesëmbëdhjetë ditë” tregon një periudhë kohore të tetë ose pesëmbëdhjetë ditëve pune dhe jo një ose dy javë.

Shprehja “gjysmë muaji” do të thotë një periudhë kohore prej pesëmbëdhjetë ditësh pune.

### Neni 37

Kur një kambial është i pagueshëm në një ditë të caktuar, në vendin ku kalendari është i ndryshëm nga kalendari në vendin e emetimit të tij, dita e maturimit quhet dita e caktuar sipas kalendarit të vendit të pagesës.

Kur një kambial hartohet ndërmjet dy vendeve duke pasur kalendarë të ndryshëm dhe është i pagueshëm në një kohë “të fiksuar pas datës”, maturimi do të llogaritet nga dita korresponduese e emetimit të kambialit sipas kalendarit të vendit të pagesës.

Koha për paraqitjen e kambialit llogaritet në përputhje me rregullat e paragrafit të

mësipërm.

Këto rregulla nuk zbatohen në qoftë se një term në kambial, ose edhe vetë shprehjet e tij, tregojnë qëllimin për adaptimin e disa rregullave të ndryshme.

## KREU VI PAGESA

### Neni 38

Mbajtësi i një kambiali të pagueshëm në “një datë të fiksuar” ose në një kohë të fiksuar “pas datës” ose “pas parjes” duhet të paraqesë kambialin për pagesë në ditën, në të cilën ai është i pagueshëm ose në një nga dy ditët e punës që vijojnë.

Paraqitja e një kambiali në një “Zyrë kompensimi pagesash” është e njëjtë si një paraqitje për pagesë në një “Zyrë kompensimi pagesash”.

Për sa më sipër “Zyra e kompensimit të pagesave” e autorizuar është Banka e Shqipërisë ose ndonjë shoqëri tjetër që do të ketë këtë qëllim.

### Neni 39

Pritësi që paguan një kambial, mund të kërkojë dorëzimin e një dëftese pagimi nga mbajtësi. Mbajtësi mund të mos refuzojë një pagesë të pjesshme.

Në rastet e pagesave të pjesshme, pritësi mund të kërkojë që detajet e kësaj pagese të jenë shënuar në kambial dhe t’i jepet atij një dëftesë pagimi nga mbajtësi.

### Neni 40

Mbajtësi i një kambiali është i detyruar të pranojë pagesën përpara maturimit.

Pritësi që paguan përpara maturimit, vepron kështu në rrezikun e tij.

Ai që paguan në maturim, quhet si i çliruar nga detyrimi, në qoftë se ky veprim nuk ka ardhur nga qenia e tij fajtor, si rezultat i një mashtrimi ose neglizhence të theksuar.

Ai duhet të sigurojë rregullshmërinë e vazhdimet të xhirimeve por jo nënshkrimet e xhiruesve.

### Neni 41

Kur një kambial është i pagueshëm në monedhë të huaj, shuma e tij do të paguhet në monedhën shqiptare, sipas kursit të saj në datën e maturimit.

Në qoftë se pagesa e kambialit është bërë me mungesën e debitorit, mbajtësi mundet që me pëlqimin e tij të kërkojë që shuma e kambialit t’i paguhet në monedhën e vendit, sipas kursit në ditën e maturimit ose në ditën e pagesës. Vlera e valutës në këtë rast vendoset sipas kursit të vendit të pagesës.

Megjithëkëtë, lëshuesi mund të kushtëzojë që shuma e pagueshme të llogaritet sipas një kursi të shprehur në kambial.

Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen në rast se lëshuesi ka caktuar shprehimisht monedhën me të cilën duhet bërë pagesa (kusht i pagimit efektiv në monedhë të huaj).

Në qoftë se shuma e kambialit është e specifikuar në një monedhë që ka të njëjtin emërtim si në vendin e emetimit ashtu dhe në atë të pagesës por që kanë vlerë të ndryshme, kjo do të thotë se tregimi i referohet monedhës së vendit të pagesës.

### Neni 42



Kur një kambial nuk është i paraqitur për pagesë brenda kufijve kohorë të fiksuar në nenin 38, çdo debitor është i autorizuar të depozitojë shumën tek autoritetet kompetente. (Zyra e kompensimit të pagesave) dhe pas kësaj të gjitha shpenzimet e rreziqet kalojnë në ngarkim të mbajtësit të kambialit.

## KREU VII E DREJTA E ANKESËS PËR MOSPRANIM OSE MOSPAGESË

### Neni 43

Veprimi mbi kambialin është: Drejtpërsëdrejti ose me anë të ankesës.

Veprimi është drejtpërsëdrejti në qoftë se drejtohet kundër pranuesit dhe garantuesve të tij dhe është me anë të ankesës në qoftë se drejtohet kundër çfarëdo personi tjetër të detyruar.

Mbajtësi mund të ushtrojë të drejtën e ankesës së tij kundrejt xhiruesve, lëshuesit dhe palëve të tjera të detyruara:

Në maturim:

Në qoftë se pagesa nuk është bërë kryer, dhe përpara maturimit:

- 1) në qoftë se është bërë refuzimi për t'u pranuar pagesa e kambialit tërësisht ose pjesërisht;
- 2) në rastet e falimentimit të pritësit, nëse ai e ka pranuar ose jo kambialin;
- 3) në rastet e një ndalimi pagese të kambialit nga ana e tij, edhe pse kjo nuk është konstatuar me gjyq;
- 4) në rast se ekzekutimi është kryer kundrejt të ardhurave të tij pa ndonjë rezultat;
- 5) në rastet e falimentimit të lëshuesit.

### Neni 44

Mungesa e pranimit ose e pagesës së kambialit nga ana e pritësit duhet të evidentohet me anën e një akti autentik (protestë për mospranim ose mospagesë).

- Protesta për mospranim duhet të bëhet brenda afateve kohore të “kohës së fiksuar” për paraqitjen për pranim.

- Në qoftë se paraqitja e parë, në rastet e parashikuara nga neni 24, paragrafi i parë, është bërë në ditët e fundit të kësaj kohe, protesta mund të ngrihet edhe ditën tjetër.

- Protesta për mospagesë ndaj një kambiali të pagueshëm në një “datë të fiksuar” ose në një kohë “të fiksuar pas datës” ose “pas parjes”, duhet të bëhet brenda dy ditëve të punës që ndjekin ditën në të cilën kambiali duhej paguar. Në rastet e një kambiali të pagueshëm “në të parë”, protesta duhet të ngrihet në bazë të kushteve të specifikuara në paragrafët e mësipërm të këtij neni.

Protesta për mospranim çlirohet me paraqitjen për pagesë të kambialit, si dhe me paraqitjen e protestës për mospagesë.

Mbajtësi mund të ushtrojë të drejtën e ankesës së tij pasi ka paraqitur kambialin për pagesë te pritësi: në rast se është ndaluar pagesa nga pritësi, në rast se pritësi e ka pranuar ose jo kambialin, ose në rast se është kryer ekzekutimi kundrejt të ardhurave të tij por pa rezultat.

Deklarimi i falimentimit të lëshuesit të kambialit ose deklarimi i falimentimit të pritësit të kambialit, pavarësisht nëse pritësi e ka pranuar ose jo falimentimin, i jep mbajtësit të kambialit mundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankesës.

### Neni 45

Mbajtësi duhet të njoftojë për mospranimin ose mospagesën e kambialit, xhiruesin dhe lëshuesin e tij brenda katër ditëve pune që vijnë pas ditës së protestës. Në qoftë se në kambial

është vënë kushti “pa shpenzime”, mbajtësi duhet të bëjë këtë njoftim në ditën e paraqitjes së kambialit.

Çdo xhirues brenda dy ditëve pune pas ditës në të cilën ai merr njoftimin për mospranimin ose për mospagesën e kambialit duhet të njoftojë xhiruesin e tij lidhur me njoftimin që ai ka marrë, duke treguar në mënyrë të hollësishme emrat dhe adresat e atyre që kanë dhënë njoftimet e mëparshme dhe duke vazhduar kështu të arrijë deri te lëshuesi. Afatet kohore sa më sipër fillojnë të ecin që nga marrja e njoftimit të mëparshëm.

Në përputhje me paragrafin e mësipërm, ku njoftimi është dhënë te një person që ka nënshkruar një kambial, ky njoftim duhet t’i jepet brenda të njëjtit afat kohor edhe garantuesit të tij.

Kur një xhirues nuk e ka specifikuar adresën e tij ose e ka specifikuar atë në një mënyrë të palexueshme (jo të qartë), në këtë rast mjafton që njoftimi t’i bëhet xhiruesit të mëparshëm.

Një person i cili duhet të japë njoftimin, mund ta japë atë në çfarëdo forme, madje dhe me anën e dërgimit të thjeshtë të kambialit.

Ai duhet të provojë që e ka dhënë njoftimin brenda kohës së caktuar. Quhet se njoftimi është në afat kur është bërë me letër që është dërguar në postë në afatin e përmendur.

Një person që nuk jep njoftimin brenda limitit kohor të dhënë sa më sipër, nuk humb të drejtat e tij. Ai është përgjegjës për dëmin në rastet kur kjo shkaktohet nga neglizhenca e tij, por me kusht që dëmi të mos ketë kaluar sasinë e shumës së kambialit.

#### Neni 46

Lëshuesi, xhiruesi ose garantuesi mund të çlirojnë mbajtësin e një kambiali nga hartimi i protestës për mospranim ose mospagesë, duke vënë në kambial kushtet “pa shpenzime”, “pa protesta” ose shprehje ekuivalente me to.

Ky kushtëzim (shënim) nuk e çliron mbajtësin nga paraqitja e kambialit brenda kohës së caktuar, si dhe nga njoftimet që ai duhet të japë. Barra e provës do të bjerë mbi personin, i cili pretendon për mosrespektim të afateve të caktuara nga ana e mbajtësit.

Në qoftë se shënimi është vënë nga lëshuesi, ai ka efekt kundrejt të gjithë lëshuesve, kurse në rast se ai është vënë nga një xhirues ose garantues ka efekt vetëm ndaj tyre.

Në qoftë se mbajtësi i kambialit ka hartuar protestën pavarësisht nga shënimi i vendosur nga lëshuesi, në këtë rast është mbajtësi që duhet të mbartë shpenzimet.

Kur me gjithë shënimin e bërë nga një xhirues ose garantues është hartuar protesta, shpenzimet e protestës mund të mbuloen nga të gjithë personat që kanë nënshkruar kambialin.

#### Neni 47

Lëshuesi, pranuesi, xhiruesi dhe garantuesi i një kambiali janë solidarisht të detyruar ndaj mbajtësit të kambialit.

Mbajtësi ka të drejtën e ankesës së tij kundër të gjithë këtyre personave individualisht ose kolektivisht dhe nuk është i detyruar t’i përmbahet radhës në të cilën ata kanë marrë detyrimin.

Një të drejtë të tillë do ta ketë edhe çdo person nënshkruar i kambialit që e ka marrë dhe e ka paguar atë.

Padia e ngritur kundër njërit nga të detyruarit nuk ndalon që të ngrihet padia edhe kundër të detyruarve të tjerë.

#### Neni 48

Mbajtësi i kambialit mund të kërkojë të mbulohet nga personi, kundrejt të cilit ai ushtron të drejtën e tij të ankesës, me:

1. Shumën e papranuar ose të papaguar të kambialit me interes, në qoftë se interesi ka

qenë i përcaktuar.

2. Interesin sipas kursit ligjor nga data e maturimit të parashikuar nga Kodi Civil.

3. Shpenzimet e protestës dhe të njoftimeve të dhëna, si dhe shpenzime të tjera.

Në qoftë se e drejta e ankesës është ushtruar përpara maturimit, shuma e kambialit do të jetë subjekt i një zbritjeje. Ky skontim do të llogaritet sipas shkallës zyrtare të skontimit (sipas kursit bankar) në datën kur është ushtruar ankesa, në vendin e vendbanimit të përhershëm të mbajtësit.

#### Neni 49

Pala që paguan një kambial, mund të kërkojë të mbulohet nga palët e detyruara ndaj tij me:

1. Shumën e plotë të paguar prej tij.

2. Interesin në shumën e thënë të llogaritur në kursin ligjor sipas dispozitave të parashikuara nga Kodi Civil, duke filluar nga dita kur ai kryen pagesën.

3. Çdo shpenzim të kryer.

#### Neni 50

Çdo palë përgjegjëse, kundër së cilës është ose mund të jetë ushtruar një e drejtë e ankesës, mund të kërkojë që kundrejt pagesës kambiali t'i jepet palës përgjegjëse së bashku me protestën dhe me faturën e një llogarie të pranuar.

Çdo xhirues, i cili ka paguar një kambial, mund të anulojë xhirimin e tij, si dhe xhirimin e xhiruesve vijues.

#### Neni 51

Pas një pranimi pjesor të kambialit nga pritësi, mbajtësi i kambialit mund të ushtrojë ankesë për pjesën e papranuar të këtij kambiali. Pas ushtrimit të protestës pritësi i kambialit që pagoi shumën për të cilën kambiali nuk ishte pranuar, mund të pretendojë që kjo pagesë të shënohet në kambial.

Me qëllim që të bëjë të mundur ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës së ankesës së tij, mbajtësi duhet t'i japë kësaj pale gjithashtu një kopje të vërtetuar të kambialit.

#### Neni 52

Në mungesë të çdo marrëveshjeje të kundërt, çdo person që ka të drejtën e ankesës, mund të rimbursojë vetveten me një kambial të ri (të rikrijuar), të hartuar “me të parë” mbi njërin prej garantuesve të tij dhe të pagueshëm në vendbanimin e këtij të fundit. Riprojektimi i një kambiali të ri përfshin (sipas shumave të dhëna në nenet 48 dhe 49) përqindjet e sekserit dhe shpenzimin ndaj stampimit të riprojektit.

Në qoftë se riprojekti është hartuar nga mbajtësi, shuma e pagueshme fiksohet sipas kursit të hartuar në vendin ku kambiali origjinal ishte i pagueshëm dhe sipas kursit të këmbimit të vendbanimit të përhershëm të garantuesit.

Në qoftë se riprojekti është hartuar prej një xhiruesi, shuma e pagueshme fiksohet sipas kursit të kambialit “me të parë”, të hartuar në vendin ku lëshuesi i riprojektit ka vendbanimin e përhershëm dhe sipas kursit të këmbimit të vendbanimit të përhershëm të garantuesit.

#### Neni 53

Mbajtësi do të humbë të drejtën e tij të ankesës kundrejt xhiruesve, kundrejt lëshuesit dhe

kundrejt të detyruarve të tjerë, me përjashtim të pranuesit, në rast të kalimit të afatit të kohës së fiksuar:

- për paraqitjen e një kambiali të hartuar “me të parë” ose në një “kohë të fiksuar pas parjes”;

- për hartimin e protesës për mospranim ose mospagim;

- për paraqitjen për pagesë në rastet e kushtit “pa shpenzime”.

Në qoftë se kambiali nuk është paraqitur për pranim brenda limiteve kohore të përcaktuara nga lëshuesi, mbajtësi humb të drejtën e ankesës së tij për mospagim dhe mospranim, kjo përveç rasteve kur nga përmbajtja e kambialit del se lëshuesi ka për qëllim të lirohet vetëm nga garancia për pranim.

Në qoftë se është fiksuar një kusht për paraqitje në një xhirim, vetëm xhiruesi mund ta zotërojë atë.

#### Neni 54

Në rast se paraqitja e kambialit, ose hartimi i protestës brenda afateve kohore të caktuara ndalohet nga pengesa të pakapërcyeshme, siç mund të jenë qenia e një dispozite ligjore e ndonjë shteti ose elementë të forcave madhore, atëherë afatet zgjaten nga lëshuesi.

Në raste të forcave madhore, mbajtësi është i detyruar të njoftojë pa vonesë xhiruesin e tij dhe të vendosë këtë njoftim mbi kambial ose mbi një fletë bashkëngjitur tij, duke vendosur datën dhe nënshkrimin. Ndërsa në raste të tjera do të zbatohen dispozitat e nenit 45 të këtij ligji.

Kur forca madhore ka përfunduar, mbajtësi duhet të paraqesë pa vonesë kambialin për pranim ose pagesë tek pritësi, dhe në qoftë se ky i fundit refuzon, atëherë mund të hartohet protesta.

E drejta e ankesës mund të ushtrohet në qoftë se forca madhore vazhdon të veprojë mbi 30 ditë pas maturimit të kambialit. Në këtë rast nuk do të jetë e nevojshme as paraqitja, as hartimi i një proteste.

Në rastet e kambialeve të hartuara “me të parë” ose në një “kohë të fiksuar pas parjes”, koha e 30 ditëve do të fillojë nga data në të cilën mbajtësi, edhe përpara mbarimit të kohës për paraqitjen e kambialit, i ka dhënë njoftimin për forcën madhore xhiruesit të tij.

Në rastet e kambialit të hartuar në një kohë të caktuar “pas parjes” kohës limit të mësipërme prej 30 ditëve do t’i shtohet koha limit “pas parjes” e caktuar në kambial.

Faktet krejtësisht personale të mbajtësit ose personit që i ngarkohet paraqitja e kambialit ose hartimi i protestës nuk quahen si raste të forcave madhore.

#### Neni 55

Marrëdhëniet ndërmjet personave, të cilët kanë të njëjtin detyrim mbi një kambial, rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil mbi detyrimet solidarë dhe të veçanta për çdo detyrues.

#### Neni 56

Kambiali është titull ekzekutiv për shumën bazë të tij, interesin dhe shpenzimet, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile. Ekzekutimi i mëtejshëm mbi kambialin nuk pezullohet, përveç reasteve kur kemi arsye të bazuara shumë serioze, sipas rregullave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

#### Neni 57

Në çdo procedurë gjyqësore të bazuar në veprimet mbi kambialin, debitori mund të ngrejë padi sipas nenit 2 të këtij ligji vetëm për përjashtimet për pavlefshmërinë e kambialit të

cilat nuk ndalohen në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Në rastin e pretendimeve të ngritura nga debitori, kur kërkohet një sqarim i provave të reja, gjykata me kërkesën e kreditorit nxjerr një vendim gjyqësor të përkohshëm për pagesën. Në këtë rast, sipas vlerësimit të saj, gjykata vendos një masë sigurimi me depozitë garancie kur ajo e quan të nevojshme, sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

#### Neni 58

Në qoftë se nga marrëdhëniet juridike, mbi bazën e të cilave emetohet apo xhirohet kambiali, rrjedh një veprim, ky veprim do të mbetet pavarësisht nga emetimi apo xhirimi i mëtejshëm i kambialit, përderisa nuk është provuar se ka ndodhur një ndryshim. Një veprim i tillë nuk mund të ushtrohet, në qoftë se një mospranim ose mospagese nuk është evidencuar me protestë.

Mbajtësi i kambialit nuk mund të ushtrojë të drejtën e ankimit, përveçse duke ofruar rikthimin e kambialit te debitori dhe duke e depozituar atë në gjykatën kompetente. Të gjitha formalitetet e nevojshme duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të lejojnë veprimet e mëtejshme të debitorit për ankesë në gjykatë.

### KREU VII NDËRHYRJA PËR PRANIM DHE PAGIMI I KAMBIALIT

#### 1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 59

Lëshuesi, xhiruesi ose garantuesi mund të specifikojnë një person për të pranuar a paguar kambialin në raste nevoje.

Si subjekt i mësipërm, një kambial mund të pranohet dhe paguhet nga një person që ndërhyrës për çfarëdolloj detyrimi (që ai ka dhe kundrejt të cilit ekziston e drejta e ankesës).

Personi ndërhyrës mund të jetë një palë e tretë, vetë pritësi, ose një person tjetër i detyruar në kambial, përveç pranuesit.

Personi ndërhyrës është i detyruar të japë, brenda dy ditëve punë, njoftimin e ndërhyrjes së tij te pala, për të cilën ai ka ndërhyrë në pranimin dhe pagimin e kambialit.

Në mungesë të respektimit të këtij afati, ai është përgjegjës për neglizhencën e tij, në qoftë se ka shkaktuar dëmin, por me kusht që shumica e dëmit të mos tejkalojë shumën e kambialit.

#### 2. PRANIMI PËR NDËRHYRJE (PËR PRANIM DHE PAGESË)

#### Neni 60

Pranimi për ndërhyrje mund të bëhet në të gjitha rastet kur mbajtësi i një kambiali të përshtatshëm për pranim ka një të drejtë për ankesë përpara maturimit.

Kur në një kambial tregohet një person që do të pranojë ose do të paguajë kambialin në vendin e pagesës, mbajtësi i kambialit përpara maturimit të kambialit nuk mund të ushtrojë të drejtat e tij të ankesës kundrejt këtij personi dhe kundrejt palëve nënshkruese vazhduese. Përderisa kambiali i paraqitet personit që ka ndërhyrë për pranimin e pagesës, refuzimi i pranimit të kambialit do të konstatohet me protestë.

Në raste të tjera të ndërhyrjes mbajtësi i kambialit mund të refuzojë një pranim ndërhyrjeje.

#### Neni 61

Pranimi për ndërhyrje është i dhënë në kambial dhe është i nënshkruar nga personi ndërhyrës. Ai përcakton personin, në favor të të cilit është dhënë e drejta për pranimin dhe pagimin e kambialit dhe, në mungesën e përcaktimeve të tilla, pranimi është quajtur si i dhënë për lëshuesin.

#### Neni 62

Personi që ka pranuar për të ndërhyrë në kambial është i detyruar kundrejt mbajtësit dhe xhiruesve vazhdues të palës për të cilën ai ka ndërhyrë në të njëjtën mënyrë.

Me gjithë pranimin për ndërhyrje, pala për të cilën është bërë ndërhyrja për pranim dhe pagesë si dhe garantuesit e saj mund të kërkojnë nga mbajtësi, si shkëmbim për pagesën e shumës të dhënë në nenin 48, dorëzimin e kambialit, protestën dhe, në qoftë se ekziston, një ekstrakt të llogarisë ku vërtetohet kjo shumë.

### 3. PAGESA ME NDËRHJRJE

#### Neni 63

Pagesa me ndërhyrje mund të zbatohet në të gjitha rastet kur mbajtësi ka të drejtën e ankesës ndaj kambialit, në maturim ose përpara maturimit.

Pagesa duhet të përfshijë të gjithë shumën që duhej të paguhej nga pala, për të cilën është bërë pranimi dhe pagimi i kambialit.

Pagesa mund të bëhet të shumtën një ditë pas ditës që ndjek dita e fundit e lejuar për hartimin e protestës për mospagesë.

#### Neni 64

Në qoftë se një kambial është pranuar nga persona ndërhyrës që kanë vendbanimin e përhershëm në vendin e pagesës së kambialit, ose në qoftë se në rast nevojë janë caktuar persona të tjerë që kanë vendbanimin e përhershëm të tyre në vendin e pagesës së kambialit, mbajtësi duhet të paraqesë kambialin të të gjithë këta persona. Në këto raste, në qoftë se është e nevojshme, mbajtësi i kambialit të përgatitë një protestë për mospagesë, të hartuar jo më vonë se dita që ndjek ditën e fundit të lejuar për hartimin e protestës.

Në mungesë të protestës brenda këtij afati kohor, pala e cila ka emëruar personat e nevojshëm si më sipër, ose për llogari të së cilës ka qenë pranuar kambiali dhe xhiruesit vijues, janë të shkarkuar nga përgjegjësia.

#### Neni 65

Mbajtësi që refuzon pagesën e kambialit me ndërhyrje humbet të drejtën e tij të ankesës ndaj çdo personi që mund të ketë qenë shkarkuar sipas paragrafit dy të nenit 64 të këtij ligji.

#### Neni 66

Pagesa me ndërhyrje duhet të jetë e vërtetuar me një dëftesë për pranim e vendosur mbi kambialin, duke përmendur personin për të cilin është bërë pranimi dhe pagimi i pagesës.

Në mungesë të hollësive të tilla, pagesa quhet si e bërë për lëshuesin.

Kambiali dhe protesta, në qoftë se ka ndonjë të tillë, duhet t'i jepen personit që ka paguar për ndërhyrjen.

## Neni 67

Personi që paguan për ndërhyrjen, fiton të drejtat që rrjedhin nga kambiali kundrejt palës për të cilën është pranuar dhe paguar kambiali, dhe kundrejt personave të cilët janë të detyruar ndaj këtij të fundit në kambial. Megjithëkëtë ai nuk mund ta rixhirojë kambialin përsëri.

Xhiruesit vijues të palës për të cilën është bërë pranimi dhe pagimi i kambialit shkarkohet nga përgjegjësia.

Në rastet e konkurrencës për pagesë ndaj ndërhyrjes, do të preferohet pagesa e cila prek numrin më të madh të emetimeve.

Çdo person që me një njohuri ndaj fakteve ndërhyr në një mënyrë të kundërt ndaj këtij rregulli, do të humbasë të drejtën e tij të ankesës kundër atyre që mund të kenë qenë të shkarkuar nga përgjegjësia.

## KREU IX

### PJESËT E NJË KOMPLETI (DUBLIKATAT) DHE KOPJET

#### I. DUBLIKATAT

## Neni 68

Një kambial mund të hartohet në një dublikatë prej dy ose më shumë pjesëve identike.

Dublikatat duhet të numërohen në trupin e vetë instrumentit dhe në mungesë të tij secila pjesë konsiderohet si një kambial i veçantë.

Mbajtësi mund të kërkojë lëshimin e dublikatave të kambialit me shpenzimet e tij, përveç rasteve kur rezulton se kemi të bëjmë me një kambial të vetëm. Për këtë arsye mbajtësi i kambialit duhet t'i drejtohet xhiruesit të tij të menjëhershëm, ku ky i fundit është i detyruar të kalojë veprimin të xhiruesi i tij dhe kështu me radhë deri te lëshuesi.

Xhiruesit janë të detyruar të riprodhojnë xhirimet e tyre mbi dublikatat.

## Neni 69

Pagesa e një dublikate shkarkon detyrimin e pritësit, edhe sikur të mos jetë deklaruar që një pagesë e tillë anulon fuqinë e dublikatave të tjera.

Megjithëkëtë pritësi qëndron i detyruar për çdo dublikatë të pranuar që ai nuk e ka mbuluar.

Kur një xhirues ka transferuar dublikatat te persona të ndryshëm, si dhe te xhiruesi vijues, këta do të detyrohen mbi të gjitha dublikatat që mbajnë nënshkrimet e tyre dhe të cilat nuk u janë kthyer atyre.

## Neni 70

Një palë që ka dërguar një dublikatë për pranim, duhet t'u tregojë palëve të tjera emrin e personit në duart e të cilit ajo gjendet.

Ky person është i detyruar t'ia dorëzojë këtë dublikatë mbajtësit të ligjshëm të ndonjë dublikate tjetër. Në qoftë se ai refuzon, mbajtësi nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të ankesës, përveçse pasi të konstatojë me protestë:

1. Që dublikata e dërguar për pranim nuk është i dërguar atij, me gjithë kërkesën e tij.
2. Që pranimi ose pagimi nuk mund të merret mbi një dublikatë tjetër.

## 2. KOPJET

### Neni 71

Çdo mbajtës i një kambiali ka të drejtë të përdorë, të riprodhojë një ose më shumë kopje të kambialit.

Kopja e kambialit duhet riprodhuar saktësisht si origjinali, me xhirimet dhe të gjitha deklaratimet e tjera të dhëna në kambial. Kambiali duhet të jetë specifikuar deri në fund.

Ai mund të jetë i xhiruar dhe i garantuar nga garancia në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtat pasoja si origjinali.

### Neni 72

Kopja e kambialit duhet të specifikojë personin që zotëron instrumentin origjinal. Ky i fundit është i detyruar t'i dorëzojë instrumentin e mësipërm mbajtësit të ligjshëm të kopjes.

Në qoftë se personi që zotëron instrumentin origjinal refuzon dhënien e këtij instrumenti, mbajtësi i ligjshëm i kopjes mund të ushtrojë të drejtën e tij të ankesës kundër personave, të cilët kanë xhiruar kopjen ose e kanë garantuar atë, pasi ka konstatuar me protestë që origjinali nuk i është dhënë atij me gjithë kërkesën e bërë.

Kur instrumenti origjinal pas xhimit të fundit, përpara bërjes së kopjes, përmbledh një klauzolë të tillë si: “Duke filluar që këtu një xhirim është i vlefshëm vetëm në qoftë se bëhet në kopje” ose disa formula ekuivalente me të, në këtë rast do të jetë i pavlefshëm një xhirim vazhdues (vijues) mbi origjinalin.

## KREU X NDRYSHIMET (MODIFIKIMET)

### Neni 73

Në rastet e ndryshimeve të tekstit të një kambiali, palët që kanë nënshkruar pas këtyre ndryshimeve (modifikimeve) janë të detyruara sipas kushteve të tekstit të ndryshuar, kurse palët që kanë nënshkruar përpara ndryshimeve janë të detyruara sipas kushteve të tekstit origjinal. Në rastet e pasigurisë nënshkrimi gjykohet të ketë qenë ekzekutuar përpara ndryshimit.

## KREU XI PARASHKRIMI

### Neni 74

Të gjitha veprimet të rrjedhura nga kambiali kundrejt pranuesit, parashkruhen me kalimin e tre vjetëve, duke filluar që nga data e maturimit.

Veprimet e mbajtësit kundrejt xhiruesve dhe kundrejt lëshuesit parashkruhen pas një viti, duke filluar nga data e protestës (e hartuar brenda kohës së duhur), ose nga data e maturimit, në qoftë se aty ka një kusht “pa shpenzime”.

Veprimet ndaj xhiruesve kundrejt njëri-tjetrit dhe kundrejt lëshuesit parashkruhen pas 6 muajsh, të njohura nga dita kur xhiruesi ka paguar kambialin ose nga dita kur kundër tij është ngritur e drejta e ankesës.

Veprimi për pasurim të padrejtë parashkruhet pas një viti nga dita e humbjes së veprimit bazuar mbi kambialin.



## Neni 75

Ndërprerja e parashkrimit ka efekt vetëm kundrejt personit në drejtim të të cilit është kryer (ka përfunduar) parashkrimi.

## KREU XII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 76

Pagesa e një kambiali kur bie në një ditë pushimi ligjor nuk mund të kërkohet, përveçse në ditën tjetër të punës. Kështu edhe gjithë marrëdhëniet që rrjedhin nga kambiali në paraqitjen për pranim dhe protestë, kryhen vetëm në ditë pune.

Kur ndonjë nga veprimet që rrjedhin nga marrëdhëniet mbi kambialin duhet të bëhet brenda një kufiri kohor të caktuar në të cilën dita e fundit është një ditë pushimi ligjor, atëherë kufiri kohor do të shtyhet deri në ditën e parë të punës në vazhdim.

Ditët e pushimeve të ndërmjetme përfshihen në llogaritjen e kufijve kohorë.

### Neni 77

Në llogaritjen e afateve nuk do të përfshihet dita, në të cilën fillon veprimi mbi kambialin.

### Neni 78

Për arsye të këtij ligji me kusht të vendbanimit të përhershëm do të nënkuptojnë vendin e banimit të personit.

### Neni 79

Sipas këtij ligji nenet që do t'i referohen zbatimit të drejtpërdrejtë nga ana e gjykatës, do të jenë si më poshtë:

Nenet 47, 57, 58, 84, 85, 86 e 87 si dhe nenet që indirekt do të lidhen me procedurën gjyqësore të marrëdhënieve juridike të rrjedhura nga kambiali.

## TITULLI II PREMTIM-PAGESAT

### KREU I EMETIMI DHE FORMA E PREMTIM-PAGESËS

#### Neni 80

Një premtim-pagesë përmban:

1. Termin "Premtim-pagesë" të shkruar në trupin e instrumentit dhe shprehur në gjuhën e hartimit të instrumentit.

2. Një premtim të pakushtëzuar për të paguar një shumë të caktuar parash.

3. Një deklaratë të kohës së pagesës (maturimit).

4. Një deklaratë të vendit ku kryhet pagesa.

5. Emrin e personit të cilit ose të cilëve duhet t'u kryhet pagesa.

6. Një deklaratë për datën dhe vendin ku premtim-pagesa është emetuar.

## 7. Nënshkrimin e personit, i cili emeton instrumentin (emetuesi).

### Neni 81

Një instrument, në të cilin është shkelur ndonjë nga kërkesat e përmendura në nenin 80, është i pavlefshëm si një premtim-pagese, përveç rasteve të përcaktuara në paragrafët e mëposhtëm.

Një premtim-pagesë, në të cilën nuk është specifikuar koha e pagesës, është quajtur si i pagueshëm “me të parë”.

Në mungesë të hollësive të veçanta, vendi ku është emetuar instrumenti është quajtur si vendi i pagesës, që është në të njëjtën kohë edhe vendi i vendbanimit të përhershëm të emetuesit të premtim-pagesës.

Një premtim-pagesë, në të cilën nuk jepen hollësitë e vendit ku premtim-pagesa është emetuar, në këtë rast do të quhet si i bërë (kryer) në vendin e përmendur pranë emrit të emetuesit të premtim-pagesës.

Premtim-pagesa mund të jetë emërtuar gjithashtu “Pagesë kambiali”.

### Neni 82

Dispozitat e mësipërme që rregullojnë marrëdhëniet për kambialin zbatohen dhe te premtim-pagesa, deri atëherë kur ato nuk janë kontradiktore me natyrën e këtij instrumenti:

- Xhirimi (nenet nga 11 deri te neni 20).
- Maturimi (nenet nga 33 deri te neni 37).
- Pagesa (nenet nga 38 deri te neni 42).
- Ankesa në rastet e mospagimit (nenet nga 43 deri te neni 50 dhe nga neni 52 deri te neni 58).
- Pagesa ndaj ndërhyrjes (neni 59, si dhe nenet nga 63 deri 67).
- Kopjet (nenet 71 dhe 72).
- Modifikimi (neni 73).
- Parashikimi (nenet 74 dhe 75).
- Dispozitat e përgjithshme (nenet nga 76 deri te neni 79).
- Zhvleftësimi (nenet nga 84 deri te neni 87).
- Protesta (nenet nga 88 deri te neni 93).
- Dispozitat e mëposhtme janë gjithashtu të zbatueshme te një premtim-pagesë:
  - Dispozitat në lidhje me një kambial të pagueshëm në adresë të një pale të tretë ose në një lokalitet tjetër nga ai i vendbanimit të përhershëm të pritësit (nenet 4 dhe 27); kushtet për interesa (neni 5); mospërputhjet në lidhje me shumën e pagueshme (neni 6); vetëdija e nënshkrimit nga një person, i cili vepron pa autoritetin e duhur ose tejkalon autoritetin e tij (neni 8); si dhe dispozitat në lidhje me një kambial në të bardhë (neni 10).

Dispozitat e mëposhtme janë gjithashtu të zbatueshme ndaj një premtim-pagese.

- Dispozitat lidhur me garancinë ndaj kambialit (nenet nga 30 deri te neni 32).

Në rastet e parashikuara në nenin 31, paragrafi i fundit, në qoftë se garancia nuk përcaktohet në emrin e të cilit ajo ka qenë dhënë, ajo quhet si e dhënë në emrin e emetuesit të një premtim-pagese.

### Neni 83

Emetuesi i një premtim-pagese është i detyruar në të njëjtën mënyrë si pranuesi i kambialit.

Premtim-pagesa e pagueshme në një kohë të caktuar pas parjes duhet të jetë e paraqitur për “vizën” e emetuesit brenda afateve kohore të fiksuara në nenin 23. Afatet kohore fillojnë nga

data e nënshkrimit të “vizës” nga emetuesi mbi premtim-pagesën.

Refuzimi i emetuesit për të dhënë “vizën” e tij me datën në të, duhet të jetë përcaktuar në një protestë (neni 25), datë e cila përcakton fillimin e periudhës kohore pas parjes.

### TITULLI III PROTESTA DHE ZHVLEFTËSIMI

#### KREU I ZHVLEFTËSIMI

##### Neni 84

Në rast humbjeje, vjedhjeje ose dëmtimi të kambialit, mbajtësi i fundit i tij njofton me shkrim lidhur me ngjarjen e ndodhur sa më sipër pritësin, si dhe bën kërkesë-padi në gjykatë lidhur me zhvleftësimin e kambialit.

##### Neni 85

Gjykata, pasi shqyrton faktet e duhura mbi të drejtën e mbajtësit të kambialit, i deklaron me vendim të shpallur pritësit amortizimin e kambialit përkatës dhe autorizon pritësin të kryejë pagimin e kambialit:

- a) 30 ditë nga data e shpalljes së vendimit të saj, në qoftë se ka kaluar data e maturimit të kambialit, ose në qoftë se kambiali ishte emetuar “me të parë”; ose
- b) në datën e maturimit, në qoftë se kjo do të ndodhte pas shpalljes së vendimit.

Debitori nuk do të jetë përgjegjës për pagesën e një kambiali të bërë përpara se të marrë njoftimin mbi aktin e amortizimit.

Gjatë afatit të sipërpërmendur 30-ditor, mbajtësi aktual i kambialit mund të ngrejë një kundërpadi në gjykatë dhe të njoftojë për këtë lëshuesin, pritësin dhe personin që ka kërkuar amortizimin me qëllim që të provojë se e ka fituar me të drejtë kambialin, pa mashtrim ose neglizhencë.

##### Neni 86

Pasi afati 30-ditor të ketë kaluar pa ndonjë kundërshtim të ngritur në gjykatë, ose në qoftë se kundërshtimi i ngritur ka qenë refuzuar nga gjykata, kambiali i amortizuar bëhet i paefekshëm dhe ai që përpiloi kërkesën për amortizim fiton shumën e pagesës së kambialit kundrejt paraqitjes së aktit të amortizimit dhe të vendimit të shpallur nga gjykata, e cila vlerëson mosekzistencën ose refuzimin e ndonjë kundërshtimi të ngritur.

##### Neni 87

Në ndonjë rast, gjithnjë pas amortizimit, mbajtësi aktual ruan të drejtën e ankimit të tij, në qoftë se e ka ndonjë të tillë, kundrejt personit në favor të të cilit ka qenë deklaruar amortizimi.

#### KREU II PROTESTA

##### Neni 88

Protesta është një deklaratë në formën e një akti autentik i bërë prej personave juridikë ose fizikë të autorizuar, duke vlerësuar mospranimin ose mospagimin e kambialit.

Protesta përmban:

1. Datën e paraqitjes dhe të protestës.
2. Emrin e personit i cili ka kërkuar hartimin e protestës.
3. Përcaktimin e vendit ku është bërë paraqitja dhe protesta.
4. Objektivin për të cilin është kërkuar, emrin e personit të cilit i drejtohet kërkesa si dhe përgjigjet e arritura.
5. Emrin e plotë dhe nënshkrimin e personit hartues të protestës.

#### Neni 89

Personat juridikë ose fizikë të autorizuar për të përpiluar protestën janë:

1. Banka e Shqipërisë.
2. Bankat e autorizuar nga Banka e Shqipërisë.
3. Noteria.

Një autorizim i shprehur do të specifikojë nivelet e punonjësve të bankave të cilëve u njihet kjo e drejtë.

#### Neni 90

Protesta përpilohet mbi kambialin (ose në kopjen e tij ose në një pjesë të tij) apo në një fletë ngjitur kambialit, që mund të jetë ngjitur nga personi i cili përpiloi protestën, duke bashkëngjitur nënshkrimin e tij në pjesën ku bashkohet kambiali me fletën e sipërpërmendur.

#### Neni 91

Siç është përcaktuar në dispozitat përkatëse të këtij ligji, protesta bëhet në vendin e pagesës, kundrejt personit të cilit duhej t'i paraqitej kambiali. Protesta do të përpilohet edhe në qoftë se pritësi është shpallur i pagjetur ose ka vdekur, e përcaktuar kjo sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile.

Në qoftë se vendbanimi i personit është i pagjetshëm, protesta bëhet në bashkinë e vendit të pagesës, të dhënë në kambial.

Kambiali duhet të jetë i paraqitur gjatë orëve normale të punës.

#### Neni 92

Nëse lëshuesi nuk ka kërkuar në mënyrë të qartë që të përpilohet protesta mbi kambialin, protesta zëvendësohet (në qoftë se mbajtësi i kambialit është dakord) me një deklaratë të njëjtë si protesta që nënshkruhet nga pritësi, ku ky i fundit vendos për mospagimin ose mospranimin e kambialit. Një deklaratë të tillë pritësi e përpilon mbi kambial ose mbi një fletë që i bashkëngjitet kambialit. Deklarata e mësipërme ka të njëjtin efekt sikurse protesta në rast se ajo është bërë në të njëjtin kufi kohor si te protesta.

#### Neni 93

Të dhënat mbi personat, kundrejt të cilëve është hartuar një protestë, duhet të regjistrohen në buletin publik të protestave (i përcaktuar me një rregullore të veçantë).

Vetëm protestat për mospagimin publikohen në këtë buletin publik të protestave. Megjithatë protesta për mospagimin e hartuar kundrejt pritësit, i cili nuk ka pranuar kambialin, nuk do të publikohet në buletin.

Rregullat që drejtojnë publikimin periodik të këtij buletini, formalitetet e regjistrimit,

kundërshtimet, kërkesat për anulimin e hyrjeve dhe aspektet e tjera, vendosen sipas rregullave të Bankës së Shqipërisë.

Neni 94

Në zbatim të këtij ligji, Banka e Shqipërisë nxjerr aktet përkatëse nënligjore.

Neni 95

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.1414, datë 20.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**